

Numri:06 ~ 12/2016.



Balkan PERSPECTIVES

Revistë për ballafaqimin me të kaluarën

CILIT VEND I PËRKET?

..... 06


**NGA BOTË PARALELE DREJT
VLERAVE TË PËRBASHKËTA**

..... 18



**Kombi im. Kombi yt.
Kombi ynë?**

03. EDITORIAL		
04. VOX POP		
06. CILIT VEND I PËRKET?		
07. “ZRBR MUND TË SHNDËRROHET NË MJET KUNDËR ZHVILLIMIT TË NACIONALIZMIT!”		
10. A ËSHTË NACIONALIZMI E ARDHMJA JONË (EVROPIANE)?		
12. ROJTARËT E NACIONALIZMIT		
14. KUJTIMI I SË KALUARËS PËR TË NDËRTUAR NJË TË ARDHME MË TË MIRË		
		E KALUARA PO NGULFAT TË ARDHMEN E MAQEDONISË 16.
		NGA BOTË PARALELE DREJT VLERAVE TË PËRBASHKËTA 18.
		INVESTIMI I KAPITALIT SIMBOLIK NË KULTURËN POPULLORE: MUZIKA TURBOFOLK DHE SUBJEKTI KOMBËTAR FEMËROR 20.
		LAJME DHE PËRDITËSIME 23.
		IMPRESSUM 24.





EDIT- ORIAL

Prishtinë, nëntor 2016

Të dashur Lexues,

Ballkani është një rajon ku përgjatë historisë së tij, kufijtë kanë ndryshuar shumë herë. Kufijtë janë imponuar nga fuqitë e huaja, janë thyer, janë rivizituar, janë zhvendosur dhe janë kontestuar për vite me radhë. Me paraqitjen e konceptit të shtetit-komb dhe përballë mungesës së madhe të stabilitetit në rajon, gjatë shekullit të kaluar nacionalizmi është përhapur në të gjithë rajonin dhe vazhdon të jetë ende shumë relevant edhe sot e kësaj dite.

Në numrin e gjashtë të revistës *Balkan.Perspectives* ne mëtojmë të hedhim dritë mbi atë se si nacionalizmi ndërlihet me proceset e ballafaqimit me të kaluarën; si përhapet ai dhe cilat janë mundësitë dhe rreziqet që nacionalizmi bart me vete.

Edhe pse shumica e autorëve e kuptojnë nacionalizmin si diçka negative, që pengon dialogjet e hapura dhe gjithëpërfshirëse apo pikëpamjet për historinë, seksioni “Vox Populi” ilustron se jo të gjithë e kuptojnë nacionalizmin si diçka negative, mirëpo mirëpo e shohin edhe si një formë të dashurisë për vendin e tyre. Megjithatë, shumë e barazojnë nacionalizmin me racizëm.

Po ashtu, artikujt vënë në dukje se ka shumë mënyra si t’i qasemi temës së nacionalizmit. Disa nga autorët paraqesin qëndrimet e tyre personale për këtë temë dhe përshkruajnë se si dhe kur ata janë përballur me nacionalizmin. Për shembull, Lejla Mahmut përshkruan se teksa rritej në qytetin e saj të lindjes, Shkup, ajo është përballur me reagime mosbesuese dhe përjashtuese në bazë të mbiemrit të saj. Nora Hasani ndan me ne kujtime të fuqishme dhe tronditëse nga e kaluara e saj, që përfundojnë me deklaratën e saj ku ajo bën thirrje që ne ta kujtojmë të kaluarën për të parandaluar mizoritë në të ardhmen.

Edhe autorë të tjerë eksplorojnë përvojat e ndryshme me nacionalizmin. Kështu, Zllatan Delliq përshkruan përdorimin e ideve dhe simboleve nacionaliste në muzikën turbofolk, duke hedhur dritë mbi rolin e këngëtareve gjatë viteve nëntëdhjetë. Slobodan Georgiev shkruan për skenën e huliganëve në Serbi dhe lidhjet e fuqishme të tyre me

nacionalizmin serb, duke kritikuar me forcë strukturat shtetërore në Serbi që nuk i luftojnë seriozisht rrjetet huligane dhe denoncon “vlerat tradicionale serbe”. Elldin Buljubashiq sjell argumente për një Ballkan mbinacional në të ardhmen dhe merr Evropën si shembull që duhet ndjekur nga vendet e Ballkanit në vend se ato të shkojnë shtegut të nacionalizmit. Skënder Asani analizon ndikimin e narrativave nacionaliste të së kaluarës tek politika e sotme në Maqedoni dhe na paralajmëron se zhvillimi i shoqërisë në Maqedoni do të mbetet në vendnumëro. Mira Kostiq shkruan për bashkëqytetarët e saj në Maqedoni një apel të fuqishëm kundër pozicioneve nacionaliste. Në fund, në intervistën tonë me Nicolas Moll, ai shpjegon rolin potencial të Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor (ZRBR) në Ballkanin Perëndimor për të promovuar paqen, për të arritur pajtimin dhe për t’iu kundërvënë nacionalizmit në rajon. Si pjesëtar i Ekipit Moderues, ai ndan me ne shpresat dhe aspiratat e tij për këtë organizatë të re.

Ashtu si në numrat e mëparshëm të revistës, qëllimi ynë është të ofrojmë këndvështrime të ndryshme, e ndonjëherë kontraverse. Ne ftojme që në këtë debat të përfshihen pikëpamje nga më të ndryshmet dhe që të angazhohemi në mënyrë kritike në këto biseda të vështira, në mënyrë që diskursi publik të jetë gjithëpërfshirës dhe të arrijmë progres në mënyrë paqësore. Jeni të mirëseardhur të bëheni pjesë e këtij diskutimi direkt me ne përmes emailit ose Facebook-ut.

2016 ka qenë një vit i trazuar, me shumë zhvillime në Ballkanin Perëndimor, por edhe në nivel ndërkombëtar. Disa nga këto zhvillime tregojnë se ka ende nevojë t’u kundërvihemi lëvizjeve nacionaliste dhe se është me rëndësi që t’i bëjmë thirrje mirëkuptimit njerëzor dhe respektit të ndërsjellë.

Pres me padurim të vazhdojmë punën tonë bashkë me ju drejt këtyre vlerave edhe në vitin 2017!

Gëzuar festat!

Maike Dafeld/ Kryeredaktore



KU

dhe

SI E

keni

**PERJETUAR
NACIONALIZMIN?**



BOSNIA DHE HERZEGOVINA

Nacionalizmin e përjetoj çdo ditë. Unë jetoj në një komunitet të ndarë në baza etnike. Jetoj në një qytet ku është normale të jesh nationalist dhe të duash vetëm grupin tënd etnik dhe fetar. Gjithçka tjetër është e padëshirueshme dhe e papranueshme. Asnjë shprehje e diversitetit nuk pranohet. Individët që janë të ndryshëm, janë në pozitë shumë të vështirë. Ndonjëherë është shumë e lodhshme të jesh gjatë të gjithë kohës i rrethuar nga nacionalizmi.

Adnan G., 30

Nacionalizmi është i lidhur ngushtë me jetën në Bosnje e Hercegovinë. Unë e përjetoj dhe jetoj me të çdo ditë. Nacionalizmi është në rrugë, në media dhe në qëndrimet e njerëzve. Është bërë faktori më definues në identitetin e njerëzve të vendit tim. Për fat të keq, nacionalizmi është rendi i ditës.

Zorana D., 30

Kur miqtë e mi më gjykojnë se shoqërohem me një "ustash" edhe pse jam në klasën e pestë të shkollës fillore.

Ismet G., 19

SERBIA

Ngaqë jam rritur në një mjedis kozmopolit, përballja ime me nacionalizmin nuk ka qenë e drejtpërdrejtë. Erdhi një çast kur nisa të vërej zhvillimin e mentalitetit të të qenit nën rrethim, së pari në shkollë e më vonë tek miqtë e mi në universitet; mentaliteti për shkak të të cilit ata ndjeheshin vazhdimisht të kërcënuar dhe nën presion. Pashë se si ky mentalitet pengonte zhvillimin e tyre personal dhe profesional. Edhe pse disa nga miqtë e mi ishin në gjendje ta kuptonin natyrën e paarsyeshme të nacionalizmit dhe të linin pas mendimet e tyre të vjetra, për fat të keq shumë prej tyre u zhytën edhe më thellë në këtë ideologji të rrezikshme.

Srgjan L., 38

Përveç politikës ditore tinzare, unë e kam përjetuar nacionalizmin edhe në mënyra të vogla, për shembull kur njerëzit në transport publik bëjnë komente nacionaliste, nëpër takime me rrethin e gjerë familjar apo gjatë ligjëratave të mësuesve. Edhe muzika më e popullarizuar është shndërruar në nacionaliste. Tekstet dhe meloditë kanë ndryshuar për t'u përputhur me narrativën mbizotëruese të grupit.

Sllavisha D., 37

Doganieri në aeroportin e Vjenës mendonte se isha e bukur deri kur pa pasaportën time!

Vanja O., 42

KOSOVA

...P.sh. nacionalizmin e vërej gjatë lojërave të futbollit, në pjesëmarrjen e Kosovës dhe të shqiptarëve nëpër lojëra evropiane dhe ndërkombëtare.

Meti H., 36

Zakonisht, këtë ndjenjë e përjetoj kur udhëtoj nëpër botë dhe më pëlqen të theksoj se jam kosovar.

Kujtim K., 28

Gjatë jetës time, kam përjetuar ndjenja të kundërta që lidhen me nacionalizmin. Nacionalizmi si një gjendje e detyrueshme emocionale e çdo qytetari të mirë: një ndjenjë e superioritetit të vlerave, traditave, madje edhe pamjes fizike, ndaj të Tjerëve. Më vonë, të vinte turp të thoje "jam nationalist", sepse brenda një shoqërie që bënte përpjekje për të gjetur vendin e saj në mesin e botës perëndimore, ajo deklarata të barazonte me një individ të prapambetur dhe jashtë modës. Tani, nacionalizmi për mua është përbërësi i nevojshëm që rrjedh nga dashuria për vendin, popullin, kulturën dhe identitetin tim, që mund të na inkurajojë të kanalizojmë energjitë e secilit grup "të ndryshëm" drejt një bote më të mirë për të gjithë.

Lindita B., 40

MACEDONIA

E kam përjetuar nacionalizmin disa herë. Një herë ka ndodhur gjatë një takimi të organizuar nga një organizatë ndërkombëtare kur unë punoja me një program për të rinjtë. Një pjesëmarrëse në aktivitet tha se ajo vetë nuk dëshiron të ketë partneritet me asnjë vend ballkanik, pasi është rajon i luftërave.

Valentina J., 41

Fjalën nacionalizëm e kuptoj si një sëmundje mendore dhe një çështje shumë komplekse. Nacionalizmi në vendin tim është i pranishëm në çdo sferë të jetës: në muzikë, në sporte dhe në kulturë. Tani, unë vazhdimisht irritohej kur njerëzit përdorin sportin për të përhapur nacionalizëm.

Eliza G., 15

Nacionalizmi barazohet me kancerin; ai nuk është pjesë e sistemit natyral. Mirëpo po të mos bësh jetë të shëndetshme dhe normale, ai mund të shfaqet në ndonjë prej organeve të tua dhe me shpejtësi të përhapet nëpër trup. Gjasat për fatalitet janë të njëjta.

Svetlana S., 28

CILIT VEND I PËRKET?

Emri i babait tim është Avnoj. Nuk është emër i përveçëm, por shkurtesë e një organizate shumë të rëndësishme që lidhet me Luftën e Dytë Botërore dhe me të kaluarën partizane të ish-Jugosllavisë. Kur më pyesin për emrin e tij dhe unë e tregoj, njerëzit menjëherë e marrin me mend të kaluarën politike të familjes time. E rritur me diskursin e vëllazërim dhe bashkimit, familja ime nuk diskutonte tema që kishin të bënin me etno-nacionalizmin. Të ushqyerit e urrejtjes ndaj “tjetrit” thjesht nuk ishte opsion dhe madje konsiderohej si diçka e prapambetur dhe primitive. E megjithatë, kishte disa tema, si martesat e përziera ndërmjet praktikuesve të feve të ndryshme, që nuk mirëpriteshin krahehapur e ndonjëherë, edhe kundërshtoheshin. Ekzistonte një prag i caktuar se deri ku familja ime ishte kozmopolite dhe progresive.

Pjesën më të madhe të fëmijërisë dhe adoleshencës i kam kaluar në Shkup duke më pyetur se kush jam dhe ç’emër kam, gjithnjë duke aluduar tek prejardhja ime etnike dhe fetare. Këto pyetje më bënin të ndjehesha se nuk i përkisja qytetit ku familja ime kishte jetuar për breza të tërë. Edhe pse emri im më nuk tingëllonte i veçantë kur erdha të jetoj në Sarajevë, shumë njerëz ende supozojnë se e dinë ku “përkas” dhe pastaj më pyesin “a je e jona?”

Nacionalizmi tenton t’i kategorizojë individët në një grup të vetëm sipas etnisë së tyre. Ai luan me identitetet e njerëzve dhe me dëshirën e tyre të fuqishme për përkatësi kombëtare, që shërben për të mobilizuar dhe mbrojtur vendin apo territorin e dikujt. Nacionalizmi mbështetet tek ekzistenca e “tjetrit” dhe dëshira për ta dominuar atë. Nacionalistët dinakë kanë bërë që njerëzit të cilët i përkasin një grupi më të madh me identitet të fortë kombëtar ose fetar të ndjehen rehat dhe të sigurtë dhe nga ana tjetër, individët që nuk u përkasin grupeve të tilla të ndjehen të vetëm dhe të vuajnë nga izolimi. Kjo është arsyeja prapa përpjekjeve të mia për t’u përzier dhe për t’u pranuar si pjesë e grupit më të madh etnik. Ajo ka qenë periudha e jetës time kur kisha emocione ndaj flamurit dhe himnit të vendit. Me kalimin e kohës, këto ndjenja u zbehën pasi u vendosa në Sarajevë, ku fare

lehtë mund të bëhesha anëtare e grupit më të madh dhe të ndjeja sigurinë dhe ngrohtësinë e përkatësisë. Mirëpo ai nuk ishte më realiteti apo dëshira ime. Unë e kuptoja rrezikun që vjen kur i përket verbërisht një grupi të madh etnik e sidomos kjo për gratë. Nacionalizmi u cakton individëve role gjinore, duke mohuar identitetin gjinor jashtë kategorisë tradicionale të dyzuar mashkull-femër. Të menduarit e tillë të dyzuar dhe ndjenjat nacionaliste ushqejnë dhunën kundër grave, që arrin kulmin gjatë kohërave të luftës. Gratë dhe burrat përbëjnë kombin, mirëpo ndikimi i luftës tek gratë është rrënjësisht ndryshe për shkak të rolit të grave si bartëse të kombit.

Në fund, nacionalizmi sjell përfitime për burrat dominues që ose nxjerrin përfitime nga lufta, ose përfitime politike gjatë kohës së paqes. Edhe gratë që përshtaten me rolet gjinore të përcaktuara nga nacionalizmi, simbolikisht gjithnjë konsiderohen si “tjetra”. Sakrifika e grave në kohën e luftës për mirëqenien e kombit është e padiskutueshme. Ato së pari identifikohen si komb dhe pastaj si gra. Manipulimi me gratë vazhdon edhe pas vuajtjeve nga tmerret e rënda gjatë luftës. Ato vazhdimisht shihen si pjesëtare të grupeve etnike përkatëse. Edhe kur ju jepet mbështetje dhe kujdes, kur bëhen hulumtime për vuajtjet që u janë shkaktuar dhe kur merren vendime për të ardhmen e tyre, ato kryesisht identifikohen përmes përkatësisë në ndonjë grup të caktuar dhe jo si individë. Gratë vazhdojnë të përfaqësojnë kombin, edhe pse është rol që kombi ua ka caktuar dhe arsyeja se përse kanë përjetuar atë dhunë.

Unë nuk tentoj më të përzihem me grupet dominuese etnike pavarësisht sa e vetmuar apo e frikësuar ndjehem. Mundësia më e mirë që kanë gratë kundër nacionalizmit është t’i kundërshtojnë rolet e përcaktuara gjinore. Mundësia jonë më e mirë është të mos i përkasim asnjë vendi tjetër pos botës.



Aktualisht, **Lejla Mamut** është Koordinatore për Dhunën Sektuale të Ndërlidhur me Konfliktin pranë Zyrës së UN Women në BeH. Ajo ka master në të Drejtat e Njeriut dhe Demokraci nga Universitetet e Sarajevës dhe Bolonjës, ndërsa teza e saj e masterit për gjenocidin është vlerësuar si një nga më të mirat e brezit të saj. Ajo ka mbi shtatë vjet përvojë pune në pasojat e

luftës dhe të drejtat e viktimeve të krimeve ndërkombëtare dhe njohuri të thella për kontekstet vendore sa i përket krimeve të luftës, sidomos dhunës seksuale të ndërlidhur me konfliktin. Ajo ka certifikatë nga Medica Zenica për arsim në fushën e komunikimit, traumave psikologjike, përballimit të përvojave traumatike dhe ndërhyrjes në raste krizash.

“ZRBR mund të shndërrohet në mjet kundër zhvillimit të nacionalizmit!”

Si anëtar i Ekipit Moderues që po fasiliton procesin e themelimit të Zyrës Rajonale për Bashkëpunim të të Rinjve (ZRBR) të Ballkanit Perëndimor, Nikolas Mol (Nicolas Moll) përshkruan potencialin e organizatës së re për t'iu kundërvënë nacionalizmit dhe për të promovuar paqen dhe pajtimin në rajon. Në të njëjtën kohë, ai paralajmëron për pritshtëri të skajshme rreth marrëveshjes për ZRBR.



Ju keni prejardhje franko-gjermane. Si ka ndikuar në jetën tuaj shtetësi e dyfishtë dhe lidhja me të dy vendet?

Fakti që jam rritur në Francë dhe Gjermani i ka kontribuar interesave të mia për bashkëpunim ndërkombëtar dhe ndërkulturor. Nisa të bëja pyetje si: cilat janë sfidat në marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve? Si mund të punojnë bashkë persona të rritur në shoqëri të ndryshme? Si mund t'i përballojnë në mënyrë konstruktive dallimet politike, shoqërore dhe kulturore?

Cila është përvoja juaj me Zyrën e të Rinjve Franko-Gjermanë (ZRFGJ)? Çfarë ka qenë, është dhe do të jetë ende e vlefshme për Gjermaninë dhe Francën?

Unë kam punuar në ZRFGJ nga viti 2001 deri në 2007 dhe që atëherë kam vazhduar të punoj me organizatën duke marrë pjesë në projekte të ndryshme shkëmbimi. Kur ZRFGJ u themelua në vitin 1963, pas nënshkrimit të Traktatit të Miqësisë Franko-Gjermane, kishin kaluar 18 vjet nga Lufta e Dytë Botërore. Ideja e të dy qeverive ishte që për të arritur pajtimin, vetëm bashkëpunimi politik

dhe ekonomik nuk mjaftonin. Ishte e nevojshme të ndërtohej një bazë popullore për këtë proces të pajtimit duke i dhënë mundësinë të rinjve nga të dy vendet që të takoheshin dhe të njiheshin me njëri-tjetrin, të krijonin lidhje dhe të zhvillonin aktivitete të përbashkëta. Sot, më shumë se 50 vjet më pas, qëllimi kryesor i ZRFGJ nuk është promovimi i pajtimit ndërmjet dy vendeve. Nuk jemi më në periudhën e pasluftës dhe konsiderojmë se sot, vendet tona janë pajtuar, edhe nëse ka ende çështje të ndjeshme që lidhen me historinë e të dy vendeve. Mirëpo duke mos qenë më në periudhë të pasluftës nuk do të thotë se marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve janë “natyralizuar”: bashkëpunimi franko-gjerman nuk mund të merret si i mirëqenë; secili brez i ri duhet të mësojë sërish si t'i përballojnë sfidat e bashkëpunimit ndërkulturor dhe ndërkombëtar. Bashkëpunimi aktual franko-gjerman në nivel politik nuk është i shkëlqyeshëm – duke e bërë kështu edhe më të rëndësishme që të rinjtë nga të dy vendet të debatojnë për këtë marrëdhënie (dhe çështje të tjera) dhe për mundësitë për përmirësim.

A është e zbatueshme përvoja franko-gjermane edhe në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe si?

Po dhe jo. Jo, nëse mendoni të kopjoni pikë për pikë përvojën franko-gjermane dhe ta sillni në Ballkanin Perëndimor. Kurrë nuk mund të kopjosh pikë për pikë një përvojë nga një kontekst dhe pastaj ta zbatosh si të tillë në një kontekst tjetër, sepse secila përvojë është unike. Por po, përvoja franko-gjermane – si dhe përvoja të tjera – mund të jenë të dobishme për rajone të tjera nëse mbani parasysh dallimet dhe nëse e shihni atë përvojë si mundësi për frymëzim për atë që dëshironi të arrini në shoqëritë tuaja. ZRFGJ ka frymëzuar themelimin e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim të të Rinjve (ZRBR) në Ballkanin Perëndimor – ZRBR sigurisht që ka mjaft ngjashmëri me ZRFGJ, por edhe tiparet e veta specifike. Për shembull, ZRBR është institucion shumëpalësh dhe jo dypalësh.

Cilat janë rreziqet më të mëdha për shoqëritë e sotme të Ballkanit pas viteve të dhunshme në të '90-tat? Si mund t'u kundërvihet ZRBR këtyre rreziqeve?

Në mesin e rreziqeve të ndryshme, këmbëngulja e fuqishme e diskurseve dhe qëndrimeve nacionaliste është sigurisht një prej tyre. Në këtë kontekst, vendet fqinje shpesh nuk shihen si partnerë potencialë, por ende si armiq kërcënues dhe si dash kurban për problemet e brendshme. Ndarjet politike dhe personale brenda rajonit mbeten të larta, ndërmjet dhe brenda vendeve. ZRBR nuk do të jetë në gjendje të zgjidhë të gjitha problemet e Ballkanit, por shpresoj se do të mund të kontribuojë për zgjidhjen e disa prej tyre. ZRBR mëton të inkurajojë më shumë të rinj nga Ballkani Perëndimor që të takohen me të rinj nga vendet fqinje dhe të udhëtojnë për të zbuluar vendet fqinje, duke u dhënë kështu mjete për t'u marrë me ndasitë ekzistuese.

Ky numër i revistës *Balkan.Perspectives* shtjellon temën e nacionalizmit dhe si nacionalizmi është përhapur në shoqëritë e sotme të Ballkanit. A është ZRBR nismë që do të parandalonte mbizotërimin e fuqishëm të diskurseve dhe besimeve nacionaliste?


Në Marrëveshjen zyrtare të nënshkruar në korrik 2016, që themelon ZRBR, qëllimi i deklaruar është të “mbështesë aktivitete që promovojnë pajtimin, mobilitetin, diversitetin, vlerat demokratike, pjesëmarrjen, qytetarinë aktive dhe të nxëniet ndërkulturor”. Pra po, ZRBR mund të shndërrohet në një mjet kundër zhvillimit të nacionalizmit. Projektet e mbështetura nga ZRBR, takimet dhe aktivitetet e përbashkëta të të rinjve nga vende të ndryshme në Ballkanin Perëndimor do të krijojnë mundësi për të diskutuar probleme si nacionalizmi dhe në të njëjtën kohë, të jenë hapësira për të trajtuar paragjykimet kundër grupeve të tjera vendore dhe sociale. Por kjo nuk ndodh vetëm pse njerëzit me të cilët ata takohen do të tejkalojnë paragjykimet: përvojat në të kaluarën kanë treguar se nëse një takim ndërmjet personave

nga vende të ndryshme organizohet keq, ai mund t'i kontribuojë fuqizimit të paragjykimëve ekzistuesë. Prandaj është shumë e rëndësishme që të arrijmë cilësi pedagogjike të këtyre takimeve që do të organizohen dhe të kemi persona të kualifikuar dhe të trajnuar për t'i organizuar këto takime. Në përgjithësi, vetë ZRBR më vete nuk është mjaft për t'u marrë me diskurset nacionaliste, mirëpo mund të japë ndihmesën e vet në këtë drejtim.

Çfarë është ZRBR? A mund ta shpjegoni shkurtimisht këtë nismë?

ZRBR është de facto një organizatë e re ndërkombëtare e krijuar nga qeveritë e Shqipërisë, Bosnje e Hercegovinës, Kosovës, Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë, qëllimi i të cilës është të mbështesë – në aspekt financiar,

shumë të mirë. Për shembull, të gjitha propozimet e shtjelluara nga Grupi Punues për ZRBR në të ardhmen janë marrë me vendim me konsensus nga të gjithë pjesëmarrësit dhe jo me shumicë votash. Ka patur vetëm dy çështje të ndjeshme në aspekt politik mbi të cilat Grupi Punues nuk ka mundur të pajtohet dhe që paraqitën nevojën për vendim direkt nga niveli i qeverive. E para kishte të bënte me çështjen operacionale: ku do të vendosej zyra qendrore e ZRBR? Pati opsione të ndryshme, por më në fund të gjashtë qeveritë u pajtuan që të vendosej në Tiranë dhe unë mendoj se ishte një lëvizje e zgjuar: Shqipëria nuk ka qenë pjesë e Jugosllavisë dhe kështu ka një pozitë disi më specifike në krahasim me pesë vendet e tjera. Çështja tjetër e vështirë ishte: sa para duhet të



logjistik dhe pedagogjik – programe për shkëmbimin e të rinjve brendapërbrenda Ballkanit Perëndimor. Kjo do të thotë që organizatat rinore, shkollat dhe individët që duan të organizojnë aktivitete me të rinj nga dy, tre apo më shumë vende nga rajoni mund të aplikojnë për fonde për të organizuar projekte të tilla. Sigurisht që takimet mes të rinjve në rajon kanë ekzistuar edhe para vitit 2016, por ZRBR ka krijuar një kornizë që do t'u ndihmojë më shumë të rinjve të organizojnë dhe të marrin pjesë në projekte të shkëmbimit të të rinjve.

Cilat kanë qenë sfidat kryesore gjatë negociatave për ZRBR?

Në vitin 2015, gjashtë qeveritë krijuan Grupin Punues me Përfaqësues të Ministrive të Rinisë dhe organizatat e të rinjve në gjashtë vende për të zhvilluar propozime konkrete se si do të dukej ZRBR në të ardhmen. Brenda këtij grupi ka patur bashkëpunim

kontribuojnë qeveritë për ZRBR? Ka patur disa ide që paratë kryesisht të vijnë nga donatorë të jashtëm. Për fat, të gjashta qeveritë u pajtuan që kontributet e tyre të përbashkëta të përbëjnë 50%, 1M Euro nga buxheti vjetor total prej 2M Euro, që është një shenjë e qartë e përkushtimit të tyre. Pronësia e ZRBR është në rajon dhe jo jashtë tij. Një tjetër sfidë ishte gjetja e barazpeshës ndërmjet ndikimit të qeverive dhe të shoqërisë civile. Tani Bordi Drejtues, që është organi më i lartë vendimmarrës i ZRBR do të përbëhet njëjtë nga përfaqësues të Ministrive të Rinisë dhe të organizatave rinore nga të gjashta vendet. Ky është një shembull se shoqëria civile do të luajë rol të rëndësishëm brenda ZRBR.

Pse Kroacia dhe Sllovenia nuk janë anëtare të ZRBR?

Ato nuk janë anëtare të ZRBR, sepse qeveritë e Kroacisë dhe të

Slovenisë nuk u pajtuan të bëhen pjesë. Ato e kishin mundësinë të ishin anëtare themeluese, por vendosën të mos e bëjnë. Ndoshta ngaqë janë tashmë pjesë e BE-së, kanë vlerësuar se nuk kanë nevojë të marrin pjesë në një ndërmarrje të tillë rajonale. Kjo është për të ardhur keq, sepse një nga synimet e ZRBR është të mbështesë pajtimin dhe bashkëpunimin rajonal, ndaj është thelbësore që sidomos Kroacia të përfshihet. Edhe nëse Kroacia dhe Sllovenia aktualisht nuk janë anëtare të ZRBR, Statuti i miratuar nga gjashtë qeveritë parasheh mundësinë për të zhvilluar programe të shkëmbimit me vende të tjera, përfshirë Kroacinë dhe Slloveninë. Kjo do të thotë se edhe të rinjtë nga këto dy vende do të kenë mundësi të marrin pjesë në programe të shkëmbimit që mbështeten nga ZRBR. Marrëveshja zyrtare për ZRBR deklaroi se ZRBR është e hapur për anëtarësime të reja. Kjo do të thotë se nëse një ditë qeveria e Sllovenisë dhe/ose Kroacisë duan të bashkohen, dera është e hapur.

Cilat janë planet e ZRBR për aktivitetet në të ardhmen?

Deri në fillim të vitit 2017 duhet të ndërmerren hapa të ndryshëm administrativë dhe logjistikë, në mënyrë që ky institucion i ri të jetë funksional. Për shembull, hapat përfshijnë emërimin e anëtarëve të Bordit Drejtues, zgjedhjen e Sekretarit të Përgjithshëm, punësimin e stafit dhe hapjen e zyrës qendrore në Tiranë dhe të degëve lokale në pesë vendet e tjera. Në gjysmën e parë të vitit 2017 do të lansohet thirrja e parë për aplikime për projekte, në mënyrë që organizatat dhe individët e interesuar të aplikojnë për grante dhe të implementojnë projekte. Do të jetë shumë e rëndësishme që në muajt e ardhshëm ZRBR të bëhet shumë e njohur përmes aktiviteteve të ndryshme informuese dhe sensibilizuese në mënyrë që sa më shumë të rinj në rajon të mësojnë për mënyrat se si mund të marrin pjesë dhe t'i kontribuojnë kësaj nisme të re.

Si do të ndikojë ZRBR në jetën e të rinjve në Ballkan?

ZRBR mëton të krijojë më shumë mundësi për të rinjtë që të takohen, shkëmbejnë dhe të zhvillojnë aktivitete me të rinj të tjerë, kryesisht nga vendet fqinje. Për disa njerëz, këto takime mund të kenë ndikim fare të vogël, ndërsa për të tjerë të madh. Këto programe mund t'i kontribuojnë ndryshimit të perspektivave për ndonjë temë apo ndonjë vend tjetër, për të zhvilluar marrëdhënie të reja, për të marrë ide të reja. Kjo mund të ndikojë pozitivisht tek jetët e të rinjve. Të marrim një shembull: përmes një vizite studimore në Maqedoni dhe Kosovë të organizuar në dhjetor 2001 nga ZRFGJ, ishte hera e parë që unë udhëtoja për në Ballkanin Perëndimor. Tani unë jetoj në rajon, prej pothuajse dhjetë vjetësh dhe Ballkani Perëndimor është bërë tema kryesore e aktiviteteve të mia profesionale, si hulumtues dhe praktikues. E gjitha kjo filloi me një udhëtim një-javor. Unë njoh shumë të tjerë për të cilët, pjesëmarrja në ndonjë program mësimor ndërkombëtar ka patur ndikim të rëndësishëm dhe pozitiv në jetën e tyre.

Cilat do të ishin sfidat më të mëdha në fillimin e punës së kësaj nisme?

Një nga sfidat më të mëdha do të ishte të shihej se sa do të jetë në gjendje ZRBR t'i kontribuojë jo vetëm jetëve individuale, por edhe në nivel shoqëror dhe rajonal. Një nga dallimet kryesore ndërmjet ZRFGJ dhe ZRBR është se e para u krijua në bazë të traktatit të miqësisë franko-gjermane, ku është ngulitur fort vullneti politik për të ndryshuar marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve. Ndërsa ZRBR është krijuar pa marrëveshje politike ndërmjet vendeve të përfshira, prandaj qëndron disi e izoluar. Mirëpo nuk duhet ta ngarkojmë ZRBR me shumë pritshmëri. ZRBR mund t'i kontribuojë ndryshimeve pozitive në rajon. Nëse ajo u kontribuon ndryshimeve në jetën e individëve, atëherë ndoshta mund t'i kontribuojë edhe ndryshimeve pozitive më të mëdha në rajon. Shumë nga kjo

varet nga mënyra se si ZRBR, Bordi Drejtues dhe Sekretari i Përgjithshëm dhe partnerët e shumtë në nivel baze do të pozicionohen në hapësirën publike. A do ta shohin veten thjesht si një mekanizëm administrativ për shkëmbime ndërmjet të rinjve, apo do të bëhen zë konstruktiv në debatin publik? A do të jetë një zë që i thotë haptazi jo nacionalizmit dhe po diversitetit, vlerave demokratike, kompleksitetit dhe dallimeve si elemente thelbësore për shoqëritë tona? Roli i shoqërisë civile do të jetë thelbësor. Akterët e shoqërisë civile do të kenë rol të rëndësishëm në strukturat vendimmarrëse të ZRBR dhe shpresoj se ata do ta shfrytëzojnë këtë mundësi për ta bërë ZRBR një akter të ndryshimeve pozitive në Ballkan dhe në Evropë.

Më shumë informacion për ZRBR, përfshirë dhe Marrëveshjen zyrtare dhe Statutin mund t'i gjeni në: www.rycowersternbalkans.org



Nicolas Moll ka studiuar Histori Bashkohore dhe Shkenca Politike në Freiburg i. Br., Gjenevë, Aix-en-Provence dhe Strasbourg dhe ka gradën e doktorit në Histori Bashkohore nga Universiteti i Frajburgut (University of Freiburg). Pasi ka punuar si profesor dhe koordinator i Departamentit të Studimeve Kulturore dhe të Gjuhës Gjermane pranë Institutit të Studimeve Politike në Paris (Institut d'Etudes Politiques) ai ka kaluar gjashtë vjet si Kryesues i departamenteve të "Trajnimit Pedagogjik Ndërkulturor" dhe "Hulumtim dhe Vlerësim" pranë Zyrës Rinore Franko-Gjermane (ZRFGJ) në Berlin. Që nga viti 2011, ai punon si historian dhe trajner i pavarur në fushën e bashkëpunimit ndërkulturor, ku merret me të kaluarën dhe zhvillimin e shoqërisë civile. Që nga viti 2015, ai është anëtar i Ekspertit të Moderimit të Zyrës Rinore Franko-Gjermane që fasilton procesin e themelimit të Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor (ZRBR) të Ballkanit Perëndimor. Marrëveshja zyrtare për krijimin e ZRBR u nënshkrua me 4 korrik 2016.

A ËSHTË NACIONALIZMI E ARDHMJA JONË (evropiane)?



Brexit e ka tronditur procesin e integritimeve evropiane dhe e ka futur Evropën në mendime. Rishikimi i rolit, idesë dhe vizionit të Bashkimit Evropian është bërë sërish prioritet i kontinentit të vjetër. Parë nga perspektiva jonë ballkanike, ekzistojnë mjaft dykuptimësi sa i përket Evropës dhe komunitetit evropian. Procesi i gjatë i evropianizimit të Ballkanit është vënë në pikëpyetje si rezultat i trendit të ri: ballkanizimit të vetë Evropës. Ballkanizimi i Evropës është aluzion i procesit të fragmentimit në elemente më të vogla (rajone ose shtete) brenda Bashkimit Evropian.

Dëshira për të ashtuquajturin ballkanizim i Evropës është një ide që ka ekzistuar për një kohë shumë më të gjatë se sa ngjarjet në fund të shekullit të kaluar. Shembujt e Katalonjës dhe Vendit Bask në Spanjë, marrëdhëniet ndërmjet flamandëve dhe valonëve në Belgjikë, si dhe referendumi i kohëve të fundit në Skoci po tregojnë se identiteti kombëtar dhe/ose etnik nuk është një kategori e tejkualuar. Globalizimi dhe procesi i përsheptuar i krijimit të organizatave mbikombëtare po lënë gjurmë të thella mbi kombësinë. Organizatatat ndërkombëtare si Organizata Botërore e Tregtisë, Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore kanë patur një ndikim

të madh mbi veprimet politike të vendeve, që gjithashtu ka ndikim tek vetë pavarësia apo sovraniteti i vendeve gjatë implementimit të aktiviteteve politike dhe arritjes së interesave kombëtare. Evropa ka bërë dhe një hap më tej në përpjekje për të përafuar interesat e Shteteve Anëtare me interesin e përbashkët nëpërmjet Komisionit Evropian, Bankës Qendrore Evropiane dhe organeve të tjera. Po bëhen përpjekje për të rregulluar marrëdhënien ndërmjet Shteteve Anëtare përmes akteve ligjore, ndërsa nga ana tjetër ka përpjekje për të rregulluar gjendjen brenda vetë Shteteve Anëtare. Janë shfaqur institucione të fuqishme mbikombëtare dhe organe të BE-së edhe para përfundimit të procesit të krijimit të shteteve të reja kombëtare në trojet evropiane.

Ekstremet ndërmjet strukturave mbikombëtare dhe kthimi tek nivele më lokale të vendimmarrjes me të cilat po përballlet sot Evropa po marrin formën e të qenit "të papashkuar në diversitet". Tranzicioni i mpërehët drejt identitetit mbikombëtar ka krijuar njëfarë pakënaqësie në rastin e grupeve etnike dhe kombeve ende të padefinuara. Pamundësia për të konsumuar dhe gëzuar tërësisht identitetin kombëtar dhe etnik po krijon frustrim në rastin e disa grupeve. Procesi që do të kishte rezultuar në një identitet evropian është kthyer në fillim. Parandalimi i disa grupeve që të mos gëzojnë veçoritë e tyre kombëtare me shpresën se do ta tejkalojnë ndjesinë e veçantësisë së tillë dhe do të lëvizin eventualisht drejt një identiteti të vetëm evropian e sfidon idenë e një Evrope të bashkuar. Lëvizja e fuqishme mbikombëtare në Evropë ka rezultuar në rryma të fuqishme që kundërshtojnë një lëvizje të tillë, ndërkohë që vënë në dukje frikën nga humbja e mundshme e identitetit dhe veçantësisë kombëtare. Evropa mund të nxjerrë mësim nga marrëdhëniet shoqërore në Jugosllavi dhe marrëdhëniet ndërmjet identitetit kombëtar dhe atij mbikombëtar. Këtu mund të përqendrohemi në mënyrë të veçantë tek marrëdhëniet në Bosnje e Hercegovinë. Gjatë takimit të Këshillit Antifashist të Mbrojtjes Kombëtare të Jugosllavisë gjatë LDB, u vendos që Bosnja e Hercegovina ishte një bashkim i popujve, me fjalë të tjera, i serbëve, kroatëve dhe myslimanëve me "m" të vogël. Bosnje e Hercegovinës iu dha statusi i republikës, ndërkohë që alternativa ishte ideja e ankesimit me Serbinë, gjë që edhe pse nuk ndodhi, shërbeu si një zile alarmi. Shtypja e problemeve të pretendimeve kombëtare që nuk kanë marrë fund edhe sot e kësaj dite ka rezultuar në një pothuajse-zgjidhje me anë të së cilës Bosnje e Hercegovina u bë një nga gjashtë republikat ku kishte serbë, kroatë dhe të tillë që nuk vetëdeklaroheshin se i përkisnin ndonjë kombi, apo myslimanë. Sipas Kushtetutës së Jugosllavisë së asaj kohe, shteti përbëhej nga gjashtë republika: Bosnja e Hercegovina, Mali i Zi, Kroacia, Sllovenia, Serbia dhe Maqedonia. Nga ana tjetër, simboli i Jugosllavisë kishte pesë pishtarë apo simbolë të popujve përbërës: malazetët, kroatët, sllovenët, serbët dhe maqedonasit. Termi

boshnjak, që nënkupton qytetar i Bosnje e Hercegovinës, nuk përdorej. Edhe pse termi boshnjak ishte ndaluar që në kohërat e Austro-Hungarisë në 1906, fjala boshnjak nënkuptonte shtetasin e vendit dhe përdorej gjerësisht në bisedat e përditshme. Pishtari i gjashtë u shtua si rezultat i Kushtetutës së vitit 1971, që në një farë mënyre ishte përpjekje për të zbutur gjendjen; myslimanët u bënë Myslimanë, që e ndërlikoi situatën edhe më shumë. Termi boshnjak ende nuk përdorej. Pritjet se Myslimanët do të hiqnin dorë nga përpjekjet e tyre për të gëzuar veçantësinë e tyre që iu ishte mohuar për pothuajse një shekull dhe se dalëngadalë ata do të pranonin shpirtin e të qenit jugosllavë ishte një huqje. Popujt me identitet kombëtar të garantuar bënë përpjekje për të ruajtur veçantësinë e tyre dhe hodhën poshtë idenë e një kombi të ri.

Ideja e krijimit të një kombi jugosllav mund të krahasohet me idenë aktuale të krijimit të një identiteti evropian. Suksesi i një ideje që avokon heqjen dorë nga veçantësia kombëtare dhe për popujt në Jugosllavi të bëheshin jugosllavë, është thelbi i idesë së Marksit për komunizmin. Ajo ilustron më së miri nga regjistrimi i popullsisë në vitin 1991, gjatë të cilit vetëm 3% e popullsisë u deklarua si jugosllavë.

Një skenar të ngjashëm e shohim në BE, ku ndjenja e frikës nga humbja e identitetit kombëtar dhe zëvendësimi të tij me një identitet mbikombëtar ka rezultuar në kundërshtime ndaj krijimit të një identiteti të përbashkët evropian. Ka edhe raste brenda vetë shteteve ku disa grupe nuk janë në gjendje të ushtrojnë tërësisht të drejtat e tyre, si për shembull rasti i shqiptarëve në Jugosllavi, apo më saktë, në Kosovë. Zakonisht, pakënaqësia e një pakice të caktuar çon në reagim edhe më shtypës nga popullsia shumicë në formën e nacionalizmit. Marrëdhëniet e brendshme brenda vetë shteteve pasqyrohen në marrëdhëniet ndërmjet vetë Shteteve Anëtare. Kjo ka qenë e dukshme nga fakti se referendumi në Britaninë e Madhe për largimin nga BE-ja erdhi pas referendumi në Skoci. Skocia nuk e ka fituar pavarësinë, por referendumi ka shtytur ndryshime sa i përket pozitës së Skocisë brenda Mbretërisë së Bashkuar. Dalja e Britanisë së Madhe nga Bashkimi Evropian vë në pikëpyetje qëllimin e integrimi të suksesshme deri më tani.

Në bazë të përvojave dhe shembujve të përmendur, shohim të na shfaqen disa drejtime në marrëdhëniet kombëtare dhe mbikombëtare në Evropë. Drejtimi i parë ka të bëjë me popullsinë, që thekson identitetin kombëtar si parësor në marrëdhëniet evropiane. Brenda procesit të hyrjes në BE ka protesta nga frika se shtetet kombëtare do të bëhen më pak të rëndësishme dhe do të humbasin pavarësinë për të vepruar, pra edhe identitetet e tyre të ndara. Drejtimi i dytë është rezultat i globalizimit dhe lidhjeve të papritura ndërmjet shoqërive në Evropë, ndaj krijimi i institucioneve mbikombëtare ka rezultuar në

një tejkallim të fuqishëm të veçantësisë kombëtare dhe ka vënë theksin tek identiteti i përbashkët evropian. Drejtimi i fundit që nuk është shqyrtuar mjaftueshëm dhe që ka potencial, shtrihet ndërmjet dy të lartpërmendurave, pra, pajtimi. Procesi i pajtimit ndërmjet kombëtares dhe mbikombëtares është sigurisht i rëndësishëm për zgjidhjen e situatës aktuale. Mirëpo mungesa e komunikimit dhe transparencës së punës së institucioneve mbikombëtare nga njëra anë dhe vendosja e theksit tek veçantësia kombëtare nga ana tjetër është pengesa kryesore në marrëdhëniet aktuale në Evropë. Ashtu si pamë në rastin e Jugosllavisë, ku krijimi artificial i një identiteti të ri nga njëra anë dhe mohimi i identitetit kombëtar nga ana tjetër rezultoi me gjendjen aktuale në Evropë. Mungesa e kreativitetit dhe e dialogut mund të kompromentojë të gjithë procesin e integritimit.

Lënia anash e përplasjes mes identiteteve kontradiktore brenda Evropës nuk mund të jetë më pjesë e zgjidhjes. Procesi i pajtimit të kombëtares dhe mbikombëtares është me rëndësi kyçe për procesin e mëtejshëm të integritimit evropian. Kur grupeve kombëtare u jepen të drejta të tilla që ata të mos ndjehen të kërcënuar mund të jetë një bazë e fortë në procesin e pajtimit. Kjo gjë mund të jetë dhe themeli për ndryshim të marrëdhënieve në Ballkan. Vazhdimësia e procesit të pajtimit do të nxirrej në shesh dhe komunikimi transparent thekson rëndësinë e krijimit të lidhjeve dhe identifikimit të ngjashmërive ndërmjet grupeve të ndryshme dhe gjetjen e mënyrave për të tejkalluar vështirësitë.

Marrëdhëniet në Ballkanin vetë, edhe pse janë më të ndërlikuara për shkak të marrëdhënieve etnike dhe kombëtare, kanë nisur të mbështeten tek respekti dhe respektimi i të drejtave të ndërsjella. Zgjidhja e problemeve përmes një dialogu konstruktiv në vend se të lihen anash, do të ndërtojë rrugën drejt lidhjeve të së ardhmes. Nuk ka asnjë alternativë përveç të qenit të varur tek njëri-tjetri. Dallimet duhet të kultivohen, pasi ato janë vlera që shkëmbejmë ndërmjet nesh dhe na ofrojnë përvoja të pasura. Kështu do të jemi në gjendje të përballemi me sfidat e një të ardhmeje të përbashkët evropiane. Kombëtarja dhe mbikombëtarja nuk përjashtojnë njëra-tjetrën automatikisht. Një qasje kreative mund të kombinojë kombëtares me mbikombëtares.

***Eldin Buljubashiq** është anëtar i Bordit të Federalistëve të Rinj Evropianë të Bosnje e Hercegovinës. Aktualisht ai është në vitin e dytë të studimeve për master pranë Universitetit të Sarajevës, Fakultetit të Shkencave*

Politike, Departamentit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Diplomacisë. Po ashtu, ai është student i vitit të parë në studimeve për master pranë Universitetit të Marmarasë në Stamboll, Fakulteti i Administrimit të Biznesit.

Rojtarët e nacionalizmit

Gjatë debatit të kohëve të fundit në parlamentin e Serbisë për programin e qeverisë së re, Kryeministri serb Aleksandar Vuçiq theksoi disa herë se ai nuk ka “zgjidhje” për huliganizmin që prek sportet dhe shoqërinë serbe. “E pranoj” tha ai “nuk mund ta zgjidh këtë, më falni, por kjo është e vërteta”.

Ende sot, njëzetepesë vjet pasi filloi shpërbërja e Jugosllavisë, kur flasim për dhunën në fushat sportive dhe stadiumet e futbollit, disa probleme duken të njëjta. Ata që janë njohur si mbështetës të vërtetë dhe unikë në kohërat kur KB Ylli i Kuq fitoi ligën e kampionëve në vitin 1991 tashmë janë shndërruar në një problem madhor për shoqërinë serbe dhe në rojtarë të nacionalizmit serb.

Lista e “mizorive” të kryera nga huliganët serbë është rritur në këto 15 vitet e fundit pas largimit të regjimit të Slobodan Millosheviqit në tetor 2000, edhe pse publiku besonte se kjo gjë nuk do të ndodhte në Serbinë e “sapolindur” demokratike.

Të njohur në vitet e nëntëdhjeta si vendi për rekrutimin e grupeve paramilitare, në mijëvjeçarin e ri huliganët serbë u shndërruan në banda të lidhura me krimin e organizuar.

Mirëpo vlerat mbeten të njëjta: ata e shohin Serbinë si viktimë të fuqive perëndimore, tek ata mbizotëron dashuria për Rusinë dhe ata mbështesin çdo lloj “vlere kombëtare tradicionale” dhe janë të gatshëm të përdorin dhunën. Këto janë themelet e grupeve të organizuara të huliganëve në Serbi që duket se besojnë që po vazhdojnë luftën për Serbinë.

Kur këto grupe u krijuan nga mesi i viteve të tetëdhjeta pas vdekjes së Titos, ata bartnin shpirtin e jetës dhe sjelljeve urbane. Grupet e para të tifozëve të futbollit të Yllit të Kuq dhe Partizanit kishin si shembuj grupe të ngjashme në Angli, ku huliganizmi lulëzoi në fundin e viteve të shtatëdhjeta.

Mirëpo lëvizja në Angli i kishte rrënjët tek lufta ndërmjet shtresave të ndryshme shoqërore dhe huliganët vinin nga shtresat më të ulëta.

Në Serbi, ashtu si dhe në pjesë të tjera të ish-Jugosllavisë, pjesëtarët e parë të grupeve të organizuara të tifozëve të futbollit ishin të rinj nga shtresat e larta dhe të mesme dhe të ishe pjesë e një grupi të tillë ishte diçka e sofistikuar.

Skena u radikalizua kur nacionalistët morën pushtetin në Serbi, nën udhëheqjen e Slobodan Millosheviqit dhe politika u shndërrua në temë të rregullt nëpër stadiumet e futbollit apo fushat e tjera sportive. Nga fillimi i luftës në Jugosllavi në vitin 1991, “mendimet” e tifozëve të futbollit u bënë relevante në skenën politike – ata që kontrollojnë masat në stadione mund të jenë të sigurtë për mbështetje të madhe nëpër rrugë apo gjatë fushatave politike.

“Askush nuk dëshiron të dëgjojë në stadium të brohoritet kundër tij” ka deklaruar disa herë Ivica Daçiq, Zëvendëskryeministër i Qeverisë së Serbisë, duke përcjellë kështu ndjenjat e politikanëve serbë.

Nëse huliganizmi në Angli i shërbeu qeverisë atje si arsytim për të implementuar një paradigmë të re ekonomike, ku klasa punëtore nuk kishte fuqi të ngrinte zërin nëpër rrugë, huliganizmi në Serbi shërbeu si mbështetje për politikën nacionaliste gjatë luftës në ish-Jugosllavi dhe si burim për rekrutimin e kriminelëve të rinj pas luftës.

Huliganët dhe agjencitë e sigurimit qeveritar kanë përfituar nga ajo “marrëdhënie e çuditshme”: udhëheqësit e grupeve ekstreme të tifozëve të futbollit kishin mbështetje për aktivitetet e tyre kriminale në Serbi, ndërsa agjencitë e sigurimit kishin kontroll mbi aktivitetet e tyre dhe ishte e mundur që ata të përdoshin për aktivitete të ndryshme politike.

Përfshirja e pjesëtarëve të grupeve ekstreme të tifozëve të futbollit në luftërat në ish-Jugosllavi është analizuar si dhe janë konfirmuar aktivitetet e tyre kriminale pas luftës.

Për më tepër, duke punuar për këtë artikull, në rrethinat e Beogradit u vranë dy drejtuesit e grupeve huligane ndërsa nga ana tjetër, një nga udhëheqësit e grupeve më të mëdha që mbështesin klubin e futbollit Partizani janë graduar në radhët e forcave policore serbe.

Në 15 vitet e fundit, administrata shtetërore ka shpallur disa herë luftën kundër atyre që përdorin sportet si mbulesë për aktivitetet kriminale. Në të njëjtën kohë, ata përdoren kur mbështetja e tyre është e nevojshme, kur u është vënë flaka ambasadave në Beograd në shkurt 2008, pasi Kosova shpalli pavarësinë apo kur në vitin 2010 në Beograd u organizua Parada e Krenarisë.

Formalisht, qeveria është e gatshme të implementojë ligjin, por kur dritat shuhen, ajo fuqizon lidhjet me ata që janë në gjendje të organizojnë për pak kohë mijëra të rinj për qëllime të ndryshme.

Sot, ata do të mbushin stadiumin e Yllit të Kuq për ndonjë lojë të rëndësishme, por nesër ata mund të mbështesin aktivitetet e partisë politike ose të jenë pjesë e grupeve të organizuara shtetërore që protestojnë në kufirin Serbi-Kosovë ose ai grup mund të sajojë kundërprotesta gjatë Paradës së Krenarisë.

Kjo “lojë” ndërmjet tifozëve ekstremë të futbollit dhe administratës shtetërore është nxitur që kur në vitin 2001 erdhi në pushtet Aleksandar Vuçiq, pasi ai ka deklaruar me krenari se ka qenë “njëri prej tyre” në vitet e nëntëdhjeta si përkrahës i Yllit të Kuq. Tani duket se atij i duhet të dënojë ata vlerat e të cilëve dhe mënyra e jetesës së të cilëve në mënyrë dramatike kanë përcaktuar vetë jetën dhe pikëpamjet e tij.

Mungesa e sinqeritetit të administratës serbe sa i përket çështjes së trajtimit të huliganizmit dhe aktiviteteve të tyre kriminale bëhet transparente kur gazetarët ose hulumtuesit përpiqen të shpalosin natyrën e vërtetë të atyre lidhjeve ndërmjet horrave dhe atyre që duhet të mbrojnë interesin e publikut dhe sigurinë e të gjithë qytetarëve.

Shteti nuk ka statistika të sakta dhe nuk ka përgjigje të duhura kur është puna tek këto çështje. Nuk është e mundur të publikohen procesverbalet nga takimi që ka mbajtur Kryeministri me udhëheqësit e disa grupeve huligane dhe ai nuk dëshiron të flasë për këtë në publik. Të dhënat e policisë për të gjitha aktivitetet kriminale të pjesëtarëve të grupeve huligane apo të dhënat e gjykatave nuk bëhen publike dhe kurrë nuk kemi ndonjë përgjigje për natyrën e lidhjeve ndërmjet policëve dhe huliganëve. Pse ndodh kjo dhe pse publiku nuk i merr përgjigjet e duhura?

Sipas punës time të mëparshme si gazetar hulumtues, ne nuk kemi përgjigje, sepse të merresh me huliganët do të thotë të merresh me nacionalizmin dhe ndikimin e tij në politikën serbe. Huliganët kanë marrë pozicionin e rojtarëve të vlerave tradicionale serbe dhe ata janë shumë të popullarizuar në mesin e të rinjve të Serbisë. Ata përdorin ndjenjat e mbështetjes së pastër për Yllin e Kuq apo Partizanin për të rekrutuar pjesëtarë të rinj dhe i përdorin ata në aktivitete të ndryshme: reketim, sigurim të klubeve të natës, trafikim të drogave dhe sulme në rrugë apo vrasje. Kur rekrutojnë, ata nuk i diskutojnë këto tema. Nëse do të jesh pjesë e grupit, duhet të dëshmosh dashurinë për klubin, për kombin dhe Serbinë dhe të respektosh Kishën Ortodokse Serbe, të jesh tifoz i heronjve serbë të luftës – nga Marko Kraljeviq i zakonshëm tek Ratko Mlladiqi dhe Radovan Karaxhiqi. Çështja është se nëse do vërtet të merresh me huliganizmin, duhet të merresh me nacionalizmin serb dhe ta shkëputësh krimin nga diçka që qëndron në vetë themelet e çka që qëndron në vetë themelet e çdo kombi në botë.

Paradigma e “vlerave serbe” iu është hequr nga duart shkencëtarëve, akademisë, shkollave dhe iu është lënë atyre për ta përdorur si karrem për ushtarë të rinj. Nuk ka rëndësi ku është fronti, në Bosnje, në Kosovë apo në rrethinat e Beogradit. Parimet janë të njëjtat. Kur qeveria serbe vendos të rivendosë “vlerat serbe” do të jemi të sigurtë se huliganizmit në Serbi i kanë ardhur ditët e fundit. Deri atëherë, çdo deklaratë nga policia apo ndonjë agjenci tjetër qeveritare është një dëshmi më shumë se asgjë serioze nuk po ndodh.



Slobodan Georgiev është gazetar që vepron në Beograd dhe punon si koordinator i programeve për BIRN-in në Serbi. Që nga viti 2001 ai punon si gazetar për javoren Vreme ku mbulon temat që kanë të bëjnë me krimin e organizuar dhe sportet. Ai ka marrë pjesë në programet e UNDP-së për drejtësinë tranzicionale dhe reformën e sektorit të drejtësisë në Serbi.

Nora Hasani Llapashtica është juriste dhe blogere nga Prishtina. Ajo shkruan për ndikimin që kanë nismat e qytetarëve tek ligjet dhe politikat shoqërore në nivel lokal dhe vendor dhe merret me çështje sociale.

KUJTIMI I SË KALUARËS PËR TË NDËRTUAR NJË TË ARDHME MË TË MIRË



Konfliktet dhe luftërat etnike në Ballkan, dëshmitarë të të cilave kemi qenë, janë nxitur nga regjimi i një oportunisti të lig, i cili ushquu nacionalizmin etnik të popullit të tij përmes një qasjeje hegjemoniste dhe populiste. Me ambiciet e tij të paarsyeshme, ai i hodhi benzinë zjarrit të armiqësisë për të krijuar Serbinë e Madhe me anë të represionit, apartejdit dhe më pas, spastrimit etnik.

Për shkak të regjimit të Slllobodan Millosheviqit, mijëra njerëz në Kosovë u vranë dhe u zhvendosën; vajza dhe gra janë përdhunuar; shumë familje kanë humbur gjithçka, deri edhe shpresën dhe më shumë se një mijë vetë ende janë të zhdukur. Familjarët e tyre të mbetur gjallë përndiqen nga pasiguria. Mungesa e të zhdukurve është një plagë e thellë që nuk shërohet.

Dëmi i shkaktuar nga represioni i regjimit serb dhe nga lufta që vijoi duket të jetë i riparueshëm. Të gjithë ata që kanë përjetuar luftërat e viteve

1990 bartin mbi vete plagë dhe shenja. Shumë prej këtyre “shenjave” nuk janë të dukshme, pasi manifestohen me trauma dhe kujtime të paprocesuara.

Kur je fëmijë, i përjeton ndryshe nga një i rritur ato që të ndodhin. Përvojat janë fragmente të zhvillimeve komplekse. Zhvillime, të cilat nuk mund t'i kuptosh nga këndvështrimi yt. Mirëpo e vetmja gjë që mëson shpejt – edhe si fëmijë – janë gjërat që kanë ndodhur, sepse “ne” jemi të ndryshëm nga “ata”.

Më kujtohet se prindërit e mi u detyruan të largohen nga vendet e punës, si shumë të tjerë gjatë përjashtimeve masive të shqiptarëve të Kosovës. Nëna ime e nënshkroi letrën e dorëheqjes nën tytën e armës. Prindërit u kthyen nga puna dhe qëndruan në shtëpi. Kjo ishte hera e parë kur ata u përpoqnë të na shpjegojnë se çfarë po u ndodhte shqiptarëve në Kosovë, si njerëzit i humbën vendet e punës. Isha vetëm katër vjeç.



Më kujtohet kur nëna ime lindi në shtëpi, sepse ishte shumë e rrezikshme të lindje foshnjen në spital, pasi të gjithë punëtorët e shëndetësisë që ishin shqiptarë të Kosovës ishin pushuar nga puna.

Më kujtohet kur i dëgjoja prindërit e mi tek flisnin për helmimet masive të nxënësve shqiptarë në shkollat publike. Ata kishin frikë mos edhe mua më ndodhte e njëjta gjë në kopsht, ndaj nuk shkova më.

Më kujtohen oficerë të armatosur rëndë që ndalonin Kikirezin tonë (Fiat 126) dhe na drejtonin kallashnikovët. Nuk e kuptoja se përse këtyre burrave me uniformë u pëlqente ta trembnin nënën time, e cila udhëtonte vetëm me ne (motra ime ishte katër vjeç, vëllai disa muajsh). Na kanë ndaluar aq shpesh, pa asnjë arsye. Kështu që mësuam të rrimë urtë, gjë që është shumë e vështirë për një vajzë, një fëmijë të vogël dhe një foshnje. Nëse babai ishte në makinë, ata gjithnjë përpiqeshin ta provokonin, që të kishin arsye për ta rrahur. Më kujtohet njëherë kur na lanë në makinë për orë të tëra nën nxehësinë përvëluese të verës.

Më kujtohet se si policët serbë arrestuan drejtorin e shkollës fillore. Ndodhi pas mësimi, para syve tanë. Ishte shqetësuese që në klasë të parë të përjetoje një mizori të tillë. Ishte dhe më e vështirë të kuptoje se përse po ndodhte.

Më kujtohet një tjetër lloj proteste kundër represionit, ku më lejuan të marr pjesë. Herët në mbrëmje i merrnim tenxheret dhe tepsitë pranë dritareve të hapura dhe u binim lehtë me shkopinje e me lugë. Ende më kujtohet ai tingulli mbizotërues i çelësave që tundeshin dhe i metalit kur e godisnim. Ai tingull përplasej nëpër qytet si një dallgë.

Më kujtohet dita kur u desh të ikim nga shtëpia. Isha shtatë vjeç. Si shumë të tjerë para dhe pas nesh, lamë pas gjithçka dhe të gjithë. Gjithçka që kishim, gjithçka për të cilën prindërit e mi kishin punuar. Sende të çmuara me të cilat ishim të lidhur, si lodra, fotografi dhe librat tanë të dashur. Të dashurit gjyshër, kushërinj dhe miq të ngushtë.

Më kujtohet xhaxhai im që qante si fëmijë kur u ndamë. Në atë kohë nuk e kuptoja trishtimin e thellë të tij, as dyshimet dhe frikën që kishin prindërit e mi kur u nisëm në udhëtimin tonë drejt Perëndimit. T'i takosh një kombi tjetër nënkuptonte se nuk ishte e sigurtë dhe nuk ishte e mirëpritur të jetosh në vendin tënd, sepse mund të të ndodhte gjithçka.

Kujtimi im më i keq është kur familja ime dhe unë u ngjeshëm brenda një kamioni-frigorifer me 30-40 të panjohur. Po e kalonim kufirin ilegalisht. Kontrabanduesit na mbyllën nga jashtë, që akush të mos dyshonte që në kamion kishte qenie njerëzore. Më vonë, nuk patëm oksigjen të mjaftueshëm. Ende më kujtohen njerëzit që thërrisnin me panik, foshnjat që qanin. Lutjet që të dërrmonin zemrën për ta ndaluar kamionin. Përpjekjet e pandalura për të thyer muret e trasha. Ne fëmijëve na ngritën lart që të merrnin ajër.

Nuk mundeshim dhe atë ditë gati sa nuk vdiqëm. Papritmas kamioni u ndal. Kishte patur një problem, ndaj u desh të dalim jashtë dhe ta kalonim natën në pyll. Më kujtohet i ftohti i tmerrshëm. Por nuk vdiqëm. Kjo kishte rëndësi. Ishim me fat se i kishim ikur luftës para se ajo të fillonte dhe nuk kishim humbur asnjë të afërm apo mik. Shumë të tjerë nuk e patën fatin tonë.

Tani, njerëzit pothuajse nuk flasin më për vitet 1990 apo për luftën. Duket sikur shumica ka zgjedhur heshtjen për të tejkaluar kujtime të pakëndëshme. Edhe pse të kujtosh të kaluarën mund të jetë e dhimbshme, ne duhet të flasim për përvojat tona, na duhet të kujtojmë pse kanë ndodhur disa ngjarje, si dhe pse filloi lufta. Është me rëndësi të ballafaqohemi me të kaluarën jo vetëm brenda komunitetit tonë, por edhe të flasim me serbët, të flasim me njëri-tjetrin për kujtimet e fëmijërisë që janë të ndërlydhura me zhvillime të pakëndëshme. Duhet të ketë një shkëmbim ndërmjet të rinjve shqiptarë dhe serbë që jetojnë në Kosovë, në mënyrë që ata të fillojnë të kuptojnë dhe të njohin njëri-tjetrin më mirë. Nëse nuk ka kontakte apo dialog ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve të zakonshëm dhe nëse të dyja anët mbeten të izoluar nga njëra-tjetra dhe ushqejnë të rinjtë dhe brezat e ardhshëm me të vërteta etnike dhe mite nacionaliste, mund të pasojnë dëme të mëdha.

Ne duhet ta kujtojmë të kaluarën së bashku, jo për të ushqyer dhe fuqizuar ndjenjat tona nacionaliste apo për të kërkuar hakmarrje për atë që ka ndodhur, por ta kujtojmë për të kuptuar dhe për të mos harruar kurrë rreziqet që mund të shkaktohen nëse ndizet ndonjë zjarr i nacionalizmit etnik dhe fillon të shkaktojë dëmin e tij.

E KALUARA PO NGULFAT TË ARDHMEN E MAQEDONISË

Mungesa e politikave gjithëpërfshirëse në Maqedoni dhe tensionet etnike në vend e kanë rrezikuar integrimin Euro-Atlantik.

Përgjatë historisë dhe ende sot e kësaj dite, Gadishulli i Ballkanit, përveçse është pikë e nxehtë e konflikteve, ka qenë dhe një rajon i rëndësishëm gjeopolitik dhe strategjik ku janë ndërthurrur interesa të ndryshme politike, diplomatike dhe ekonomike. Në të kaluarën, Ballkani ka qenë vendi i përplasjeve, konflikteve dhe bashkëpunimit si dhe kohezionit kulturor. Ballkani ka qenë rajoni i qytetërimeve të shumta; secili prej tyre ka lënë shenjën e vet tek identitetet kombëtare të popujve të Ballkanit. Mirëpo trendi i përplasjeve politike ndërmjet vendeve në rajon vazhdon dhe konfliktet etnike dhe historike dhe frustrimet ekzistojnë ende. Sot, Maqedonia është shembull për këto përplasje dhe pakënaqësi pasi ka filluar të ndahet ndërmjet fuqive të ndryshme brenda dhe rreth vendit.

Përplasjet ndërmjet shteteve-komb në Evropë dhe krijimi i hartës së re të Evropës në përfundim të shekullit të 19-të ndikuan edhe tek projektet e reja nacionaliste të Serbisë së madhe dhe Greqisë. Elitat intelektuale dhe politike serbe dhe greke të shekullit të 19-të i nisën projektet e tyre duke drejtuar sulme direkte ndaj territoreve të popujve

më të vegjël, si shqiptarët dhe maqedonasit. Serbët dhe grekët ishin përballë sfidës së krijimit të vetë identiteteve të tyre ndërkohë që merreshin me kundërshtimet nga popujt jo serbë dhe jo grekë.

Nuk është rastësi që politika aktuale e Maqedonisë ndjek hapat e tyre. Përpjekjet e tyre nacionaliste për shtetndërtim kundërshtojnë të drejtën e tyre historike mbi këto toka. Elita politike ka zgjedhur të trondisë themelet e shtetndërtimit duke krijuar një histori të anshme pa ndonjë bazë shkencore apo historike. Këto lloj politikash kanë qenë shumë të përhapura në shekullin e 19-të. Sot, ato shkojnë kundër koncepteve të reja moderne që promovojnë globalizimin në nivel ekonomik, politik dhe të sigurisë.

A mund të mos jenë të dëmshme këto politika që janë të mbështetura tek e kaluara dhe jo tek e ardhmja?

Deri në vitin 2006, Maqedonia ishte në krye të proceseve të integritit evropian në Ballkanin Perëndimor. Tani, Maqedonia po devijon nga këto procese për shkak të politikave anti-perëndimore. Duke

realizuar këtë projekt politik të importuar të “Rilindjes maqedonase”, qeveria po demaskon institucionet qeveritare se po keqpërdorin historinë. Duket se ata po punojnë në përputhje me një strategji të koordinuar mirë me shtete të tjera sllave, përfshirë Serbinë, Rusinë dhe Greqinë. Ndërkohë, integrimi i shtetit të Maqedonisë në strukturat Euro-Perëndimore do ta mbështeste kauzën e shqiptarëve. Kjo mund të jetë dhe arsyeja për konfliktet e shumta ndëretnike dhe ndërjetare në nivel politik në Maqedoni dhe për politikat anti-perëndimore të qeverisë. Integrimi Euro-Atlantik i Maqedonisë duhej të kishte qenë interes i shtetit dhe jo prioritet vetëm për përfaqësuesit e shqiptarëve. Kjo është një mënyrë për t’iu kundërvënë politikave serbo-ruse dhe e vetmja mënyrë për stabilitetin e saj dhe vazhdimin e ekzistencës.

Sot Maqedonia përballet me krizë të identitetit etnik, gjuhësor dhe kulturor që rrjedh nga kontestet e vazhdueshme me grekët, bullgarët dhe serbët si dhe nga trazimi i tenseve me komunitetin shqiptar brenda Maqedonisë. Si rezultat i ndërhyrjeve joparimore të serbo-rusëve, sot vendi ka një pozitë të dobët në arenën ndërkombëtare. Bashkëpunimi i Maqedonisë me vendet e rajonit, Kosovën dhe Shqipërinë, është i dobët. Duke patur Beogradin si prioritetin kryesor në marrëdhëniet rajonale, integrimi i Maqedonisë në BE dhe në NATO ka mbetur në vendnumëro.

Skender Asani është Drejtori i Institutit të Trashëgimisë Kulturore dhe Shpirtërore të Shqiptarëve në Maqedoni dhe Kryetar i Shoqatës së Historianëve Shqiptarë në Republikën e Maqedonisë.

Instituti i Trashëgimisë Kulturore dhe Shpirtërore të Shqiptarëve - Shkup.

<http://www.itsh.edu.mk/>

Mira Kostic është gazetare prej shumë kohësh. Ajo është dhe anëtare e Radio Televizionit të Maqedonisë dhe është specializuar në çështje që kanë të bëjnë me konfliktet.

— Nga botë paralele drejt vlerave të përbashkëta

Vras mendjen se mos ne në Maqedoni jetojmë në një botë paralele që shpërfill realitetin dhe promovon ato norma që përhapen nga disa persona me pushtet dhe që gabimisht promovohen si universale. Për më tepër, në një botë ku nevojat dhe interesat e individit shpërfillen dhe vendosen pas atyre të kolektivit. Pavarësisht rrezikut nga kritikata dhe të qenit të keqkuptuar, unë kam arritur në përfundimin se ne po jetojmë në një botë të tillë.

Ne jemi të ndarë mbi baza të partive politike, kombësisë, fesë dhe kushedi mbi çfarë bazash të tjera. Për shumë njerëz, është ende më e rëndësishme që të ngrihet flamuri i njërit komb dhe a do të flitet gjuha e tyre në institucione se sa standardi i jetesës, apo nëse qytetarët janë të barabartë para Kushtetutës dhe ligjeve. Në Ballkan, që është një përzierje e kombeve dhe kulturave të ndryshme, idetë për shtete dhe kombe të fuqishme ende lulëzojnë dhe frustrimi romantik nacionalist është arsyeja kryesore që çoi deri në ndarjen e përgjakshme dhe mizore të Republikës Sociale Federative të Jugosllavisë. Në vend që të mësojmë nga e kaluara, politikata sot ushqejnë dhe nxisin këto ndjenja nacionaliste për shkak të paaftësisë së tyre të ofrojnë zgjidhje për problemet aktuale të ekzistencës së qytetarëve të tyre. I vetmi qëllim i tyre duket të jetë që të rrinë në pushtet. Për ta ruajtur atë pushtet, ata po luajnë me zjarrin. Dhe kur duket se zjarri po iu del nga kontrolli, ata veprojnë si zjarrfikës dhe e shuajnë, edhe pse vetë e kishin ndezur.

Kjo mënyrë e (mos) trajtimit si duhet të çështjeve politike ka çuar drejt copëzimit të shoqërisë

në Maqedoni që nga koha e shpërbërjes së Jugosllavisë: nga ana e komunitetit shqiptar, njerëzit kryesisht distancohen nga procesi i pavarësisë, duke menduar se po trajtohen padrejtësisht dhe se të drejtat e tyre kolektive janë shkelur. Madje disa grupe radikale kanë shpallur Republikën e Iliridës. Nga ana tjetër, maqedonasit që kanë mundësinë historike që më në fund të arrijnë një shtet të pavarur, e kanë marginalizuar realitetin dhe kanë tentuar t'i fshehin problemet nën qilim dhe kjo çoi tek Marrëveshja Kornizë e Ohrit e vitit 2001. Maqedonia nuk ishte më i njëjti vend: formalisht e bashkuar, por e ndarë së brendshmi. Maqedonasit ndjeheshin të privuar nga sovraniteti i tyre dhe mendonin se i kishin shkelur. Nga ana tjetër, shqiptarët ndjeheshin se komunitetet e tjera duhej t'ju ishin mirënjohës për të mirat që përfituan prej tyre.

Për shkak të kësaj ndarjeje dhe frustrimi nga të dyja palët, tani që të dyja palët fokusohen tek pozicionet e tyre nacionaliste që vendosin komunitetin e tyre në qendër të politikës. Në vend se të krijojnë më shumë vende pune, të investojnë në strukturat e arsimit dhe të mbështesin të rinjtë pavarësisht etnisë të tyre, ata përdorin buxhetin dhe bëjnë përpjekje për të ndërtuar monumente të reja patriotike që përjashtojnë “palën tjetër” përkatëse dhe marrin vendime që bazohen krejtësisht tek përkatësia e tyre etnike.

Kjo ndarje shkakton padrejtësi dhe pakënaqësi në jetën tonë të përditshme:

Librat shkollorë u mësojnë fëmijëve tanë në një moshë kur ata nuk janë të aftë të kenë mendim kritik se është normale që Stojani të shkojë në universitet, ndërsa Nazmiu të jetë bari, apo se është shumë e rëndësishme se cili politikan udhëheq qeverisjen komunale.

Në mënyrë që të respektohet përfaqësimi i drejtë, qindra njerëz janë punësuar zyrtarisht nëpër institucione shtetërore sipas vijave politike. Mirëpo ata rrinë në shtëpi, sepse nëpër zyra nuk ka mjaftueshëm karrige – por rrogat vazhdojnë t'i marrin.

Të rinjtë largohen në kërkim të një të ardhmeje më të mirë përtej kufijve kombëtarë, të shkarkuar nga shantazhi dhe presioni. Ata ikin me pasaporta të Maqedonisë, si qytetarë të Maqedonisë dhe askush nuk i pyet se cilës etni i përkasin. Ata mendojnë vetëm nëse mund të gjejnë punë jashtë vendit.

A duhet të jetë kjo e ardhmja e vendit tonë? Një botë paralele ku të drejtat themelore të njeriut dhe vlerat kulturore shpërfillen? Maqedonë, shqiptarë, turq, serbë apo romë, të gjithë kanë probleme të njëjta të përditshmërisë. Nuk janë në gjendje të paguajnë faturat, u rrezikohet prona, nuk kanë qasje në sistemin e drejtësisë apo duhet ta korruptojnë dikë që të kenë qasje në sistemin shëndetësor, me këto probleme përballemi të gjithë ne.

A është dikush më shumë apo më pak njeri vetëm pse i përket një kombësie? A ishte kombësia e rëndësishme kur Artim Shaqiri shënoi golin që solli fitoren e cila u festua në mbarë Maqedoninë? A ishte Abdurahman Aliti si Ambasador në Bullgari më pak shqiptar kur ai mbrojti interesat e Maqedonisë? A ishin maqedonasit tradhëtarë kur votuan për kandidatin për president Imer Selmani?

Unë personalisht kam patur rastin të rritem dhe të zhvillohem në një mjedis me kombësi të ndryshme. Kjo gjë më ka ndihmuar të takohem nga afër me kulturën e tyre, me gjuhën, mënyrën e jetesës dhe vlerat tradicionale. Përveç The Beatles, idhujt e mi kanë qenë Ramiz Sadiku dhe Bora Vukmiroviq. Për ata nga ju që nuk e dini, këta të dy kanë qenë shokë, luftëtarë të lirisë në kulmin e Luftës së Dytë Botërore, që pritën t'i qëllonjë për vdekje në krahët e njëri-tjetrit. Unë mendoj se shkatërrimi i univeerseve paralele duhet të fillojë me fëmijët, sepse ata nuk janë të ngarkuar me paragjykime apo armiqësi. Problemi i vërtetë këtu janë të rriturit. Ata nuk i mësojnë mësimet e jetës dhe nuk mësojnë t'i përgjigjen pyetjes nëse do të vazhdojnë të jetojnë në univeerse paralele apo do të ndërtojnë një sistem të vlerave ku diskriminimi, madje dhe ai pozitiv, janë fyes dhe të papranueshëm.

Shtrohet tani pyetja: Si i ndërtojmë vlerat e përbashkëta? Si i gjejmë ato pika që na bashkojnë? Lë t'ia lëmë historinë historianëve në vend që ta keqpërdorim për qëllime politike. Le të gjejmë guximin për të kërkuar falje për padrejtësisë që u kemi bërë të tjerëve në të kaluarën. Le të fillojmë ta respektojmë njëri-tjetrin, të mësojmë të dëgjojmë, jo t'u bëjmë të tjerëve gjëra që nuk duam të na i bëjnë ne. Le t'i identifikojmë interesat dhe problemet që na çënojnë çdo ditë si njerëz, jo si shqiptarë apo maqedonas. Le të këmbëngulim në barazinë e vërtetë të qytetarëve para ligjit.

Nëse këto gjëra do të ishin prioriteti ynë, çështjet që na ndajnë do të bëheshin më të vogla dhe më anësore. Ne inkurajohemi nga fakti se ndërgjegjja qytetare ka filluar të zgjohet, së pari me protestat e shkollave të mesme, me mirëqenien sociale, me njerëzit që janë trajtuar keq dhe janë përjashtuar nga ngrohja qendrore, e deri tek i ashtuquajturit “revolucioni shumëngjyrësh“, mirëpo ende ka shumë punë. Unë ëndërroj për një sistem ku nuk do të lejojmë që të na manipulojnë në dëm të të drejtave themelore të njeriut dhe detyrave të tyre. Sa më përket mua, që tani jam për. Po ti?


INVESTIMI I KAPITALIT SIMBOLIK NË KULTURËN POPULLORE: MUZIKA TURBOFOLK DHE SUBJEKTI KOMBËTAR FEMËROR

Si shumë teoricienë, as unë nuk e konsideroj kombin të jetë një temë politike, por një gjendje mendore, "një komunitet imagjinar". [...] Pjesëtarët e një komuniteti të tillë nuk e përcaktojnë përkatësinë në bazë të disa tipareve reale dalluese, si gjuha e përbashkët, historia apo trashëgimia kulturore [edhe pse në shumë raste, tipare të tilla dalluese mund të jenë – dhe janë – të rëndësishme], por në bazë të faktit se ata mendojnë që i përkasin. [...] Në këtë kuptim, kombi funksionon si mit.

Andrew B. Wachtel, Making a Nation – Breaking a Nation

.....

Pas shpërbërjes së Republikës Federative Socialiste të Jugosllavisë në vitet 1990, diskursat etno-nacionaliste, luftërat, përdhunimet, emigracioni i dhunshëm ose vullnetar dhe spastrimet etnike u bënë pjesë e marrëdhënieve të përditshme ndërmjet ish-republikave jugosllave dhe popujve të tyre. Për shkak të një paranoje të tillë kolektive nacionaliste, për shkak të krijimit të kampeve nacionaliste, plaçkitjeve, ndarjes së kapitalit dhe të mirave publike, mprehjes së diskurseve etno-nacionaliste, paraqitjes së urrejtjes dhe vrasjes së Tjetrit si diçka normale, kultura popullore ka luajtur rol



kryesor në paraqitjen e luftës si zgjedhja e vetme e mundshme dhe më se normale. Meqë përjashtimi është parakusht për krijimin e një kombi, ndër të tjera ai mbështetet edhe në përjashtimin e grave. "Gratë shihen si pronë, sidomos në kuptimin e pronësisë, si territor dhe si kufi që duhet të "mbrohet" apo të pushtohet, në varësi të këndvështrimit. Trupi i tyre, edhe në kuptim figurativ, përbën territor dhe kufi" (Iveković, 2000). Një projekt kombëtar është gjithnjë projekt mashkullor dhe gratë janë veçse asistente. "Sigurisht, kombi është fiksion, por një fiksion që funksionon. Është një komunitet patriarkal që mundet vetëm të përjashtojë gratë, pasi baza e një kombi, ashtu si ndodh me të gjitha strukturat patriarkale, është përjashtimi i grave: të gjitha gratë iu nënshtrohen të gjithë burrave" (Blagojević, 2002). Këngëtarët femra dhe këngëtarët meshkuj të turbofolkut në fillimin e viteve 1990 e ndërtonin narrativën e shoubizit të tyre brenda diskursit etno-nacionalist dhe postulate të tilla asnjëherë nuk turbulluan vlerat shoqërore. Qëndrimi kryesor i kulturës së turbofolkut dhe performuesve të tij ndaj luftës ishte distancimi i tyre nga politika.

Këngëtarët në veçanti funksiononin si përfaqësues i grave të super-seksualizuara. Subjektet femra të seksualizuara, paraqitja dhe dukja e të cilave i afrohej pornografisë, ishte terren pjellor për krijimin e yjeve-femra brenda hapësirave të pastra etnike dhe një mundësi për para të shpejta, por edhe për të ndërtuar karriera për t'ua patur zili në industrinë e muzikës në të gjithë territorin e sllavëve të jugut. Yjet-femra të turbofolkut ishin të nevojshme dhe të duhurat gjatë luftës në ish-Jugosllavi, pasi ato i nxinin luftëtarët, haptazi dhe përmes nënkuptimeve, duke i ftuar ata për marrëdhënie seksuale. Ndonjëherë, ftesat e tilla ishin të drejtpërdrejta, ndonjëherë të nënkuptuara, gjë që varej nga prezantimi i vetë performueses femër. Në atë kohë kishte shumë yje-femra që e artikulonin pozicionin e tyre përmes këngëve të seksualizuara, videoklipeve dhe shfaqjeve e paraqitjeve personale. Një paraqitje e tillë e performueseve të turbofolkut përbënte një lloj të ri të "fuqizimit femëror" dhe idealeve që duheshin synuar.

Që në fillim të viteve tetëdhjetë dhe në kohën e Lepa Brenës, performueset e turbofolkut krijuan pozicione të definuara qartë brenda rendit kombëtar. Kënga e Lepa Brenës "Jugosllave" ishte një reklamë kombëtare për Jugosllavinë që paraqiste subjektin femër. Ajo këngë dërgonte mesazhin se gjithçka do të shkonte mirë në Jugosllavi dhe se dallimet e saj dhe uniteti i popujve të saj do të ruheshin. Ndërtimi i subjektit femër në tekstet e këngëve të saj dhe në videoklipe jepte një pasqyrë të rreme (sikurse e dëshmoi koha) të unitetit jugosllav dhe të barazisë së popujve të saj. Në një skenë në këtë videoklip, Lepa Brena, me paraqitjen e saj të zakonshme seksi (pantallona të shkurtra, këmbë të gjata, poza "provokuese"), është ulur në bashin e një anijeje dhe mbahet tek flamuri i RSFJ-së, që në mënyrë indirekte

-
-
-

i referohet pozicionit të subjektit femër në atë përrallë kombëtare dhe politike të Jugosllavisë si "bartësja femër" e kombit. Karakteristikë e çdo komuniteti kombëtar në këtë kontekst të kombit jugosllav është interesi i përbashkët që i bën ata bashkë dhe në mënyrë që ky interes të jetë edhe më shumë i përbashkët, atë interes duhet ta kenë të gjithë pjesëtarët e komunitetit. 'Edhe pse këto janë kolektivë dhe meta-narrativa patriarkale dhe mashkullore, gratë dhe/ose trupi femëror shpeshherë përdoren si material për të dërguar mesazh për një projekt të tillë kombëtar dhe kështu, gratë shihen si bartëse të kombit ose simbole të kombit. Ndërkohë që burrat janë përfaqësuesit dhe ata që bëjnë marrëdhëniet publike të kombit, që pasqyrojnë interesat e përbashkëta të popujve, gratë janë simbole të kombit" (Yuval-Davis, 2003). Një trup femëror seksi dhe i erotizuar që mbahet tek flamuri jugosllav definon dhe përcakton pozicionin e grave apo pozicionin e subjekteve femërore brenda rendit kombëtar. Një pozicion i tillë përcaktohet domosdoshmërisht si gra të bukura, seksi, të shëndetshme dhe të fuqishme jugosllave që janë bërë për të kënaqur soditjen e meshkujve, që bëhet dhe karakteristika kyçe e subjektivitetit femëror në meta-narrativën kombëtare të videoklipit të Brenës. Brena funksiononte si një përfaqësuese e idesë së identitetit jugosllav për masat në korniza të tilla kombëtare, politike dhe ideologjike.

Ceca Razhnatović dhe shumë performuese të tjera në vitet 1990 kanë përfaqësuar kombin serb. Pas martesës së saj me Arkanin në vitet 1990, ajo u imponua dhe funksionoi si ikona e stilit serb, gjë që ajo u përpoq ta shfaqë edhe në tekstet dhe videot e saj. Ceca e paraqiste veten haptazi në këngët dhe videospotet e saj si një femër e pasur dhe me jetë luksoze, por edhe si grua e devotshme serbe dhe ortodokse. Ajo në fakt po sakrifikon veten për një burrë, duke i dhënë atij vetëbesim, nuk ka frikë nga asgjë, është në gjendje të durojë dhe t'i mbijetojë gjithçkaje. Ajo gjithnjë pozicionohet si ruajtësja e identitetit dhe fuqisë së tij mashkullore. Gruaja paraqitet si rojtare e integritetit mashkullor; ajo e gdhend burrin dhe i jep atij krahët e saj. Meqë gratë brenda strukturave patriarkale dhe strukturave të pushtetit nuk mund të arrijnë sukses, ato i gdhendin burrat e tyre duke u mbështetur tek këto postulate. Ndonjëherë ata burra

janë bashkëshortë, ndonjëherë djem, baballarë ose vëllezër. "Elementi politik në rastin e Cecës është pajtimi me të gjitha transformimet trupore dhe pajtimi për të gjitha proceset e globalizuara dhe të modernizuara të trupit/formës femërore. Ajo u dërgonte serbëve mesazhin për botën përtej kufijve të atdheut të tyre duke u transformuar vazhdimisht dhe duke qenë e vetmja që kishte mjaftueshëm para për të ndjekur modën. Për shembull, gjatë izolimit dhe sanksioneve gjatë regjimit të Millosheviqit, qytetarëve të Serbisë në të vërtetë iu dha mundësia që pjesërisht të ndiqnin proceset globale kulturore ekskluzivisht përmes një transformueseje madhështore – Cecës" (Papiq, 2001).

Gjatë viteve të para të jetës së pavarur jashtë RFSJ-së, gjatë kulmit të paranojës nacionaliste dhe zellit fetar, Severina rrëmbeu zemrat e audiencës në Kroaci me këngën "Dalmate", që kishte dhe një videoklip ku ajo këndon e veshur me fustanin e bardhë të nusërisë. Kjo këngë krijoi direkt formën e dëshiruar të një vajze të re, e pozicionuar brenda fesë si E Virgjëra Marie, besnike ndaj burrit, që shmang shikimet e tij dhe nuk kryen marrëdhënie seksuale, pasi një vajzë e ruan "dëlirësinë dhe pafajësinë" vetëm për një burrë, atë të duhurin. Me praktika të tilla deskriptive, subjekti femëror imponohet si ideali i dëshirueshëm/i detyrueshëm i një vajze që para së gjithash duhet të jetë besimtare (katolike), t'i përkushtohet vetëm një burri, në asnjë mënyrë të mos jetë e shthurur dhe sigurisht, si dikush që do të ketë marrëdhënie seksuale vetëm me një burrë, i cili eventualisht do të jetë bashkëshorti i saj i ligjshëm me kurorë. Një vetë-paraqitje e tillë nuk vazhdoi gjatë në tekstet e Severinës, por sigurisht që është simptomatike e strategjisë së saj që të tërheqë vëmendjen tek vetja. Imazhi që ajo krijoi për veten u ndikua nga, por edhe ndikoi, kontekstin shoqëror, që ishte i stërmbytur me urrejtje etno-nacionaliste, retorikë ksenofobe dhe me projektin politik dhe ideologjik të krijimit të zonave të spastruara etnikisht në ish-RSFJ.

Performueset e turbofolkut në vitet 1990 në ish-Jugosllavi ishin shumë të zonjat për të dërguar mesazhet e nevojshme në media. Përveç praktikës së tyre që nuk shqetësoheshin nga lufta dhe shpërfillnin ngjarjet, ato paraqiteshin si ndjellëse të masave për të festuar. Ashtu sikurse media që luajti rol kryesor në paraqitjen e luftës në Bosnje e Hercegovinë apo Kroaci si normale, performuesit meshkuj dhe femra të turbofolkut deri në një masë të caktuar e paraqitën makinerinë e luftës dhe ideologjinë nacionaliste si normale. "Në paraqitje të tilla, gratë përfaqësonin vijën e gjakut, familjen, kombin, racën, fenë dhe çdo herë komunitetin dhe ato e kishin rolin për të siguruar kapital social simbolik. Sigurisht, ai kapital asnjëherë nuk i ka takuar grave vetë" (Iveković, 2000). Brenda kornizës nacionaliste gjinore, ato kanë funksionuar si imazhi dominues dhe i dëshirueshëm, prandaj të gjitha format e tjera të feminizmit apo feminitetit nuk kanë qenë përfaqësuese dhe ishin të panevojshme në media.

Referencat:

1. Blagojević, Marina: „Patriotizam i mizoginija: mit o srpskoj muškosti“ u Mapiranje mizoginije u Srbiji, diskursi i prakse, Beograd: AŽIN, 2002, 371-405.
2. Deliç, Zlatan: Turbo-folk zvijezda (konstruiranje ženskog subjekta u pjesmama/tekstovima Lepe Brene, Svetlane Cece Ražnatović, Severine Vučković i Jelene Karleuše), Sarajevo: TKD Šahinpašić, 2013.
3. Iveković, Rada: „(Ne)predstavljivost ženskog u simboličkoj ekonomiji: žene, nacija i rat nakon 1989.“ u Arsić, Branka: Žene, slike, izmišljaji, Beograd: Centar za ženske studije i istraživanja roda, 2000, 9-31
4. Papić, Žarana: „Europa nakon 1989: etnički ratovi, fašizacija društvenog života i politika tijela u Srbiji“ u Treća, časopis Centra za ženske studije, vol. III-broj 1-2, Zagreb: Centar za ženske studije, 2001, 12-46.
5. Yuval-Davis, Nira: „Rod i nacija: tradicija i tranzicija“ u Treća, časopis Centra za ženske studije, vol.V-broj 1-2, Zagreb: Centar za ženske studije, 2003, 208-234.
6. Wachtel, Baruch Andrew: Stvaranje nacije, razaranje nacije: književnost i kulturna politika u Jugoslaviji, Beograd: Stubovi kulture, 2001.

Zlatan Delliq (Tuzla, 1987) është teoricien letrar dhe kulturor nga Sarajeva. Ai ka diplomë universitare në Letërsi të Sllavëve të Jugut dhe Botërore dhe BCS për Gjuhë nga Fakulteti i Filozofisë në Tuzla dhe ka diplomë MA në Studime Gjinore nga Universiteti i Sarajevës. Aktualisht ai po merret me doktoraturën në letërsi. Ai merret me çështje të subjektivitetit, politikat emancipuese të letërsisë femërore në Bosnje e Hercegovinë dhe letërsinë e teorinë feministe. Ai boton artikuj shkencorë dhe tekste nëpër revista dhe koleksione të punimeve nga Bosnja e Hercegovina, rajoni dhe më gjerë. Ai është autori i librit "Turbo-folk zvijezda (konstruiranje ženskog subjekta u tekstovima/ pjesmama Lepe Brene, Cece Ražnatović, Severine Vučković i Jelene Karleuše)" (Ylli i turbofolkut (ndërtimi i subjektit femëror në tekstet/këngët e Lepa Brenës, Ceca Ražnatovićit, Severina Vučkovićit dhe Jelena Karleuhsës). Ai punon si hulumtues dhe kurator i Muzeut të Letërsisë dhe Teatrit të Bosnje e Hercegovinës në Sarajevë.

lajme dhe përditësime



numri i ardhshëm

7 i revistës *Balkan.Perspectives* shtjellon lidhjet ndërmjet ballafaqimit me të kaluarën dhe fesë. Çështjet pasqyrojnë se si feja mund të kontribuojë për një shoqëri paqësore dhe cilët elementë fetarë mund të ndihmojnë gjatë procesit të ballafaqimit me të kaluarën. Ky numër do të shtjellojë edhe rolet që ka luajtur feja në të kaluarën dhe si është keqpërdorur për të nxitur konflikte.



korigjim

Besnik Leka dhe Vojkan Arsiq – të intervistuar për artikujt “Një burrë për barazinë gjinore” dhe “Bonu burrë!” në numrin 5 të revistës – janë pjesë e programit rajonal “Djemtë dhe burrat si aleatë për parandalimin e dhunës dhe transformimin gjinor në Ballkanin Perëndimor” ose projekti Iniciativa e të Rinjve (YMI). Programi mbështetet tek përpjekjet gjithëpërfshirëse dhe programatike të CARE International në Ballkan për të luftuar dhunën ndërpersonale dhe me baza gjinore duke përmirësuar në të njëjtën kohë barazinë gjinore. Projekti YMI implementohet në Shqipëri, Bosnie e Hercegovinë, Kosovë dhe Serbi. Ai targeton të rinj dhe të reja që të kenë stil jetese të shëndetshëm; synon të krijojë mirëkuptim dhe qëndrime të kujdesshme ndaj barazisë gjinore dhe të ulë nivelin e dhunës me baza gjinore.

Hapja e Muzeut të Fëmijërisë në Luftë, 15 dhjetor 2016

Hapja e Muzeut të Fëmijërisë në Luftë është caktuar përafërsisht të ndodhë më 15 dhjetor. Ky muze unik që merret me të kaluarën përmes përvojave të të rinjve gjatë luftës do të hapet në Sarajevë në Rugën Logavina. Mirëpo aktivitetet e tij nuk do të kufizohen vetëm brenda kryeqytetit të Bosnje e Hercegovinës. Muzeu i Fëmijërisë në Luftë aspiron të jetë aktiv në të gjithë botën dhe në pjesën tjetër të vendit dhe të rajonit. Kohëve të fundit ai i ka zgjeruar aktivitetet e tij hulumtuese në të gjithë Bosnje e Hercegovinën, pasi ka punësuar hulumtues në Cazin, Banja Lluva, Llukavac dhe Mostar. Vizita nëpër ekspozitë dhe punëtorë do të vazhdojnë edhe në pjesë të tjera të vendit.

Misioni i Muzeut të Fëmijërisë në Luftë është që vazhdimisht të dokumentojë dhe digjitalizojë materiale nga fëmijëria në luftë, në përputhje me standardet më të larta dhe ato t'i paraqesë përmes mediave të ndryshme. Muzeu aspiron të rrisë vetëdijësimin e kësaj përvoje tek një audiencë sa më e gjerë që është e mundur.

Vizioni i Muzeut të Fëmijërisë në Luftë në nivel personal është që t'i asistojë tejkalimit të traumave dhe të parandalojë traumatizimin e të tjerëve. Në nivel kolektiv, qëllimi i Muzeut është të arrijë një të kuptuar të ndërsjellë për të mbështetur zhvillimin personal dhe atë shoqëror.

Themelimit të muzeut i ka paraprirë libri ‘Fëmijëria në Luftë’ me autor dhe redaktor Jasminko Halilovićin. Pjesa kryesore e librit është një mozaik me kujtime të shkurtra të mbledhura nga më shumë se 1,000 vetë që gjatë luftës kanë qenë fëmijë. Përveç se në Bosnje e Hercegovinë, libri është botuar edhe në Austri, Japoni dhe në më shumë se një duzinë vendesh të tjera. Grumbullimi i koleksionit për muzeun e pritshëm filloi në vitin 2015. Përveç sendeve personale, historive dhe dokumentave, koleksioni përmban edhe deklaratat në video nga individë që gjatë luftës kanë qenë fëmijë.

Për të mbështetur Muzeun e Fëmijërisë në Luftë, mund të blini anëtarësi për të gjithë jetën në: www.indiegogo.com/at/warchildhoodmuseum.

Mund t'i përcillni aktivitetet e muzeut në faqen e tyre në internet www.warchildhood.org dhe në faqen e tyre në Facebook www.facebook.com/warchildhoodmuseum/.

Impressum

Balkan.Perspectives publikohet nga *forumZFD*.

Forumi i Shërbimit Civil Paqësor (forumZFD - Forum Ziviler Friedensdienst), është organizatë gjermane e themeluar në vitin 1996. Kjo organizatë trajnon dhe angazhon ekspertë të paqes në rajonet e konfliktit që të bashkëpunojnë me akterët vendorë për të promovuar bashkëjetesë paqësore dhe zgjidhje pa dhunë të konflikteve. Partneri strategjik për Ballkanin Perëndimor është Pax Christi në Dioqezën e Aachen.

Në Ballkanin Perëndimor, fokusi është tek projekte në fushën e ballafaqimit me të kaluarën dhe për zhvillim të dialogut në mes të grupeve kundërshtarë. Këtu përfshihen projektet e ndërmjetësimit nëpër shkolla, mbështetja e shoqërisë civile ose zhvillimi i kapacitetit të medias për një qasje më konstruktive ndaj ballafaqimit me të kaluarën.

Programi financohet nga Ministria Federale për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik e Gjermanisë (BMZ).

KRYEREDAKTORE:

Maïke Dafeld

EKIPI REDAKTUES:

Sunita Dautbegoviq-Boshnjakoviq, Vjollca Islami Hajrullahu, Nora Maliqi, Vjera Ruljiq, Nehari Sharri

AUTORË:

Skënder Asani, Elldin Buljubasiq, Zllatan Delliq, Sllobodan Georgiev, Nora Hasani, Mira Kostiq, Lejla Mahmut

FAQOSJA:

Kokrra

SHTYPI:

Envinion

PËRKTHIMI:

LBG Communications (shqip), Bjanka Osmanoviq (BKS), Reis Kjerim (maqedonisht)

KORREKTURA GJUHËSORE:

LBG Communications (shqip), Violeta Kostadinowska (maqedonisht), Zinaida Llakiq (BKS), Tenzin Dolker (anglisht)

KONTAKTI:

Balkan.perspectives@forumzfd.de

VENDI I PUBLIKIMIT:

Köln

Forumi i Shërbimit Civil Paqësor | Forum Ziviler Friedensdienst e. V. (forumZFD)

Zyra në Kosovë: Sejdi Kryeziu 16 - Pejton 10000 Prishtina	Zyra në Serbi: Prote Mateje 17 11000 Beograd
Zyra në Bosnje e Hercegovinë: Rr. Branilaca Sarajeva 19 B 71000 Sarajevë	Zyra në Maqedoni: Rr. Borka Taleski 11/4 1000 Shkup

Mohim i përgjegjësisë

Balkan.Perspectives është krijuar si një platformë rajonale për debate konstruktive mbi ballafaqimin me të kaluarën. Pikëpamjet e paraqitura në këtë revistë janë ato të kontribuesve dhe nuk pasqyrojnë pikëpamjet e redaktorit apo të *forumZFD*-së dhe partnerëve të tij. Botuesit i kanë kontrolluar me kujdes lidhjet e internetit të promovuara në këtë revistë, por ata nuk mund të mbahen përgjegjës për përmbajtjen e faqeve të jashtme të internetit.

Kopjimi dhe rishpërndarja e këtij materiali, qoftë në formë të shtypur apo elektronike është i pranueshëm, por vetëm nëse teksti nuk ndryshohet dhe nëse përfshihen citimet e duhura. Për këtë nuk kërkohet pagesë.